

PROCEDURAT PËR APLIKIM PËR NDËRTIM HIDROCENTRALI ME KONÇESION:

- Mbështetur në Ligjin No. 9663, dt. 18/12/2006 “Për konçesionet”, ofertuesi paraqet projekt-propozimin për ndërtim hidrocentrali me koncesion pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE).
- Me urdhër të Ministrit të METE, projekt-propozimi dërgohet për vlerësim në Grupin e Oponencës Teknike Shtetërore (OTSH), i cili është vendosur pranë Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).
- Grupi i OTSH shqyrton projekt-propozimin dhe e dërgon vlerësimin teknik të tij në METE. Nëse projekt-propozimi vlerësohet negativisht, kthehet për ripunim.
- Pranë METE, është ngritur grupi që bën vlerësimin ekonomiko-financiar.
- Kur projekt-propozimi i pakërkuar vlerësohet si i mundshëm për dhënie me koncesion, atëherë METE fillon procedurat për dhënien e tij, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.27, datë 19.01.2007, *“Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve”*.